

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	19.07.2018
Për/ Za/ To:	NOTI BETON
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit -- Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.07.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NOTI BETON", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Rrethrotullimi Lakrishtë - Rrethrotullimi Arbëri**", me Nr. të Prok: 616 18 010 512 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri vlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik "NOTI BETON" sh.p.k. të dt. 18.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Rrethrotullimi Lakrishtë - Rrethrotullimi Arbëri**", me Nr. 616-18-3326-512 dhe Nr. Brendshëm 616 18 010 512, kundër Vendimit të AK -së, të datës 13.07.2018.
2. Vërtetohet vendimi i AK për listen e ngushte datë: 13.07.2018.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull "**Rrethrotullimi Lakrishtë - Rrethrotullimi Arbëri**", me Nr. Brendshëm 616 18 010 512 dhe mbështet vendimin e datës: 13.07.2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 14.05.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimiti: **“Rrethrotullimi Lakrishtë - Rrethrotullimi Arbëri”**, me Nr. 616-18-010-5-1-2, procedura e kufizuar.

Hapja e aplikacioneve nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 11.06.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë dorëzuar aplikacionet. Janë dorëzuar gjithsejtë 12 aplikacione. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Me datë 13.07.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit të prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për kandidatet e kualifikuar/pakualifikuar dhe eliminuar.

Me datë 17.07.2018, Grupi i OE “NOTI” dhe “INTEGARL” , i është lejuar qasja në dokumentacion të të gjitha aplikacioneve lidhur me këtë aktivitet.

Grupi i OE “NOTI” dhe “INTEGARL”, me dt. 18.07.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rrethrotullimi Lakrishtë - Rrethrotullimi Arbëri”**, me Nr. 616-18-010-5-1-2, kundër Jo-kualifikimit të Grupit në fjalë, në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 69: Aftësitë Teknike dhe profesionale

Neni 72: Dokumentacioni dhe informacioni shtese

I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Ne lidhje me dispozitat e shkelura të LPP-se për të cilat pretendon “Grupi i OE “NOTI” dhe “INTEGARL”, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e aplikacioneve në përputhje të plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë të gjitha pretendimet e OE.

1. Neni 59.2 i LPP “Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve” – Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet

ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

2. Neni 69.6.2 i LPP "Aftësitë Teknike dhe profesionale" - listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore.
3. Neni 72.1 i LPP "Dokumentacioni dhe informacioni shtesë" - Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose **duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.**

4. **Kërkesa e parashtruar ne DT:**

Kërkesa	Dëshmia
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Operatori ekonomik duhet të përfunduar me sukses kontrata ne lëmin e ndërtimit të rrugëve të reja ne vlere minimale prej 1,000,000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë, 14.05.2018).	Një listë të kontratave të realizuara, duke përdorur formularin standard ne Aneksi 4 duke saktësuar: titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

5. FTD 22.3 Vlerësimi i aplikacioneve - Faktorët të cilët do të merren në konsideratë gjatë ri-ekzaminimit janë: **vlera totale e referencave**

Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se ku janë shkelur këto dispozite, KK Prishtina edhe njëherë sqaron me se vijon:

Ne fazën e pare KK Prishtina ka përzgjedhur 7 OE sepse nga 12 aplikacione 7 aplikacione kane plotësuar kërkesat minimale te KK Prishtinës, mirëpo ne përputhje me nenin 52.2.2 te LPP-se (maksimum 6 kandidate) dhe faktorin e ri-vlerësimit te përcaktuar ne Dokumentin e para-kualifikimit (vlera totale e referencave) ju NUK jeni kualifikuar.

Ne përputhje me pyetjen #57 e KRPP përcakton "...Në të gjitha rastet e përfshira në paragrafin 1 të nenit 68, paragrafëve 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 përmendet shprehja si në vijim citojmë: ".....të realizuara në tri vitet e shkuara "ose "...në periudhën e shkuar trevjeçare..."). Ne kuptimin e Ligjit shprehja "tri vitet e shkuara" nënkupton: "Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim. Ne kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 shprehja ".....të realizuara në tre vitet e shkuara" nënkupton Kontratat për furnizime, shërbime dhe/ose punë të realizuara (përfunduar) në periudhën e shkuar tre vjeçare (periudha e sqaruar si më lart), dhe në rastin konkret AK ka marrë parasysh vetëm kontratat e përfunduara para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë, 14.05.2018.

LISTA E KONTRATAVE TE "NOTI BETON" E DOREZUAR NE OFERTE

Nr.	Data e nënshkruar	NR. I prokurimit	AK	TITULLI	CMIMI	Komenti i AK
1	09.09.2016	616 15 163 511	KK Prishtina	Ndërtimi I kolektorit betonarme dhe kanalizimit fekal ne rrugën mbi lumin Prishtina	2192854.60	Kontrata nuk është e natyrës së njëjtë
2	12.12.2017	616 17 94 521	KK Prishtina	Ndërtimi I kanalizimit fekal dhe atmosferik ne rrugën Fehmi Agani & Hajdar Dushi si dhe ndërtimi I ujësjellësit ne rrugën Fehmi Agani Prishtine	348679.20	Kontrata nuk është e natyrës së njëjtë

3	30.11.2018	616 17 100 521	KK Prishtina	Ndërtimi I kanalizimeve fekale dhe atmosferike ne territorin e Komunës se Prishtinës	355555.55	
4	19.09.2016	204 16 29 521	MTI	Rregullimi I infrastrukturës se inkubatoreve LLOT 1	61933.93	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë
5	09.09.2015	615 151 5 21	KK PODUJEVE	Ndërtimi I kanalizimit fekal ne Obranc	25382.94	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë
6	02.09.2015	616 15 139 521	KK Prishtine	Ndërtimi I kanalizimit fekal ne Kolovice	71923.00	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë
7	20.05.2014	614 14 13 521	KK Obiliq	Ndërtimi I copëzave te kanalizimit	67067.00	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
8	31.10.2014	614 14 13 521	KK Obiliq	Ndërtimi I copëzave te kanalizimit (Aneks Kontrate)	2931.32	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
9	08.08.2014	614 14 32 536	KK Obiliq(QKMF)	Instalimi I rrjetit te ujësjellësit ne QKMF	4954.94	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
10	11.04.2014	614 14 11 236	KK Obiliq(QKMF)	Renovimi I WC-ve te pacienteve ne QKMF	4923.83	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
I				TOTAL		

LISTA E KONTRATAVE TE "INTEGRAL" E DOREZUAR NE OFERTE

Nr.	Emri I Projektit	Investitori	Vlera	Fillimi dhe perfundimi	Komenti i AK
1	Asfaltimi I disa rrugëve dhe rrugicave ne qytet	KK PODUJEVE	371156.18	21.09.2016-MAI 2017	Pranuar
2	Asfaltimi I disa rrugëve ne fshatin Merdar	KK PODUJEVE	194187.69	03.08.2016-20.12.2016	Pranuar

3	Asfaltimi I disa rrugëve ne lagjen Ajeti ne Fshatin Sveqel	KK PODUJEVE	63952.67	04.10.2016-19.12.2016	Pranuar
4	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale për vitin 2016 52017 , regjioni I Prishtinës	MI	450000.00	TE REALIZUARA DERI ME 12.07.2017	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë
5	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale për vitin 2016 2017 , regjioni I Prishtinës	MI	450000.00	TE REALIZUARA DERI ME 12.07.2017	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë
6	Asfaltimi I rrugëve ne fshatin LIVADICE lagjet Oraca dhe Shkërejli	KK PODUJEVE	56725.31	21.06.2016-22.09.2016	Pranuar
7	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale për vitin 2015 2016 , regjioni I Prishtinës.	MI	1,392,190.31	Nëntor 2016	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë
8	Asfaltimi I rrugës Lagja Haxha Fshati Lupq I poshtëm dhe lagja Krasniqi Fshati Majac	KK PODUJEVE	23957.87	Tetor 2015	Pranuar
9	Asfaltimi I rrugës Dediija ne fshatin Penuhë	KK PODUJEVE	59699.45	Tetor 2015	Pranuar
10	Asfaltimi I disa rrugëve ne fshatin Lluga te Podujeves	KK PODUJEVE	49918.83	18.05.2015-21.08.2015	Pranuar
11	Asfaltimi I disa rrugëve ne fshatin Lluga te Podujeves	KK PODUJEVE	49918.83	18.05.2015-21.08.2015	Pranuar
12	Asfaltimi I dy rrugëve ne fshatin Radujevc	KK PODUJEVE	62574.26	Shtator 2015	Pranuar
13	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale për vitin 2014	MI	1193514.76	2014/2015	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë

	2015 , regjioni I Prishtinës				
14	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale për vitin 2013 2014 , regjioni I Prishtinës	MI	1039101.49	2013/2014	Kontrata nuk është e natyrës se njëjtë
15	Asfaltimi dhe ndërtimi I rrugëve ne fshatin Ballofc	KK PODUJEVE	437340.20	2013/2015	
16	Ndërtimi I rrugës R125 ,Pjesa Orllan-Bervenik Kufi nga km18+257.27 deri ne km 25+363.48	MI	1289693.62	2013-2015	Pranuar
17	Ndërtimi I rrugës R125 ,Pjesa Orllan-Bervenik Kufi nga km18+257.27 deri ne km 25+363.48 ANKES	MI	104102.89	2015	Pranuar
18	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale për vitin 2012 2013 , regjioni I Prishtinës	MI	789615.48	2012/2013	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
19	Asfaltimi I rrugës lagja Maloku, Sejdiu dhe Avdiu ne fshatin Bellopoje	KK PODUJEVE	86297.77	2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
20	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale për vitin 2011 2012 , regjioni I Prishtinës ANKES	MI	76699.20	2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
21	Ndërtimi I rrugëve ne fshatin Bare	KK Mitrovice	80947.33	2011/2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
22	Asfaltimi I rrugës ne fshatin Orlan-lagja e Gajtaneve	KK Podujeve	81728.96	2011/2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit

23	Mirembajtja verore dhe dimerore e rrugeve magjistrale dhe regjionale per vitin 2011 2012 , regjioni I prishtines	MI	789615.48	2011/2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
24	Asfaltimi I rruges ne Lupq te eperme	KK Podujeve	128306.42	2011/2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
25	Ndertimi I rruges B faza e IV	KK Prishtine	1141021.30	2011/2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
26	Ndertimi I rruges Ndue Perlleshi	KK Prishtine	142191.91	2011/2012	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
27	Asfaltimi I rruges ne Peran (lagja Talla)	KK Podujeve	55224.93	2011	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
28	Ndertimi I rruges ne Ashlan Lgja Bahtiri Ramoshi dhe Akrashtice , lagja Mehana	MTPT	560438.46	2010/2011	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
29	Mirembajtja verore dhe dimerore e rrugeve magjistrale dhe regjionale per vitin 2010 2011 , regjioni I prishtines ANKES	MI	79471.60	2011	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
30	Asfaltimi I rruges ne Peran	KK Podujeve	60330.39	2010	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
31	Mirembajtja verore dhe dimerore e rrugeve magjistrale dhe regjionale per vitin 2010 2011 , regjioni I prishtines	MI	798196.58	2010/2011	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
32	Asfaltimi I rruges ne fshatin Rufc I Vjete	MTPT	466612.27	2010	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
33	Mirembajtja verore dhe dimerore e rrugeve magjistrale dhe	MTPT	798196.58	2009/2010	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit

	regjionale per vitin 2009 2010 , regjioni I prishtines				
34	Ndertimi I rruges regjionale Vushtrri- Polace.pune shtese	MTPT	319291.11	2009	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
35	Ndertimi I rruges regjionale Faza II	MTPT	3199395.35	2008/2009	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
36	Mirembajtja verore e rrugeve 2008,Regjioni I Prishtines	MTPT	983468.50	2008	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
37	Zgjerimi I rruges magjistrale M2 Prishtine Hani I Elezit , segmeti "Vazhdimi I zgjerimit nga cakllavica prej km1+600-km 5+200 dhe ndertimi I ures ne Llapnaselle Faza e I dhe II	MTPT	4955486.24	2008	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
38	Mirembajtja dimerore e rrugeve 2007/08	MTPT	348542.00	2007-2008	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
39	Ndertimi I rruges regjionale Vushtrri Polace	MTPT	566878.84	2007	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
40	Marrveshja per vazhdimin e kontrates me NQ TERMOKOS	TERMOKOS	140691.00	2007-2008	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
41	Furnizimi me kryp industrial per mirembajtjen dimerore te rrugeve regjionale dhe magjistrale LLOT I	MTPT	411757.43	2006-2007	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
42	Ndertimi I ures ne rr. M25 Prishtine Podujeve	MTPT	382187.00	2006	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
43	Shtrurja me zhavor e rrugeve , kanaleve te kanalizmit dhe kanaleve per ngrohen qendrore te qytetit	TERMOKOS	155797.00	2007	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit

44	Shtrurja me zhavor e rrugeve , kanaleve te kanalizmit dhe kanaleve per ngrohen qendrore te qytetit	TERMOKOS	238 750.37	2006	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
45	Mirembajtja dimerore e rrugeve 2005	MTPT	570390.94	2005	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
46	Rehabilitimi dhe asfaltimi I rruges Palaj-Lajthishte -sibovce	MTPT	386727.25	2005	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
47	Ndertimi I ures ne rrugen regjionale Shajkovc fshati Svegël	MTPT	38452.00	2005	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
48	Mirembajtja verore e rrugeve 2004	MTPT	1109890.66	2004	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
49	Shtruarja e rrugeve ne zhavor dhe asfalt ne territorin e komunave Gllogovc, Serbuçe Prishtine dhe Podujeve	KAN Ramiz Sadiku Prishtine	276000.00	2004	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
50	Mirembajtja dimerore e rrugeve	MTPT	467857.26	2004	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
51	Shtruarja e rrugeve ne zhavor dhe asfalt ne territorin e komunave Gllogovc, Serbuçe Prishtine dhe Podujeve	KAN Ramiz Sadiku Prishtine	256000.00	2003	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
52	Rehabilitimi I rrjetit te infrastruktures se ngrohjes qendrore te qytetit te Prishtines	TERMOKOS	1200.000	2003	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
53	Mirembajtja verore e rrugeve 2003	MTPT	903921.09	2003	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit
54	Shtruarja e rrugeve ne zhavor dhe asfalt ne territorin e komunave Gllogovc, Serbuçe Prishtine dhe Podujeve	KAN Ramiz Sadiku Prishtine	240000.00	2002	Kontrata nuk është realizuar tri vitet e fundit

II.		TOTAL te pranuara	2,325,887.68		
-----	--	-------------------	--------------	--	--

KONKLUDIM: Nga vlera totale e referencave ju keni me pak se 2,555,032.82 aq sa ka OE "FAMIS CO_HC" i renditur para juve.

KK Prishtina ka respektuar:

- nenin 59 te LPP-se i cili përcakton se "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij...", dhe sqaron se KK Prishtina nuk ka kërkuar informata shtese për arsye se çdo gjë ka qene e qarte ne dokumentet e dorëzuara nga Ju si OE
- nenin 69 te LPP-se , shih vlerën totale te punëve te realizuar ne krahasim me OE te renditur para jush
- nenin 72 te LPP-se i cili përcakton "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose **duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë...**", dhe sqaron se nuk ka kërkuar informata shtese për arsye se dokumentacioni i dorëzuar nga ju ka qene i plote, jo i gabuar dhe nuk kane munguar dokumentet.

Për me tepër ne datën e parashtrimit te Kërkesës për Rishqyrtim, ju keni dorëzuar një Liste te RE te Kontratave te realizuara, e qe ne rastin konkret nuk është marre parasysh gjithnjë duke u bazuar ne:

1. **Nenin 59.2 te LPP-se**, i cili nen përcakton "*Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues*" dhe
2. **Nenin 39 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik**, i cili nen përcakton

Problemi	Si te veprohet	Veprimi i KK Prishtinës
Lista e kontratave te realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale te vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Ju nuk jeni refuzuar mbi bazën e këtij kriteri por mbi bazën e faktorit te rivlerësimit

Lista e kontratave te realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë	Mund te kërkohen informata sqaruese	Ju keni dorëzuar Listën e Kontratave, prandaj nuk ka pas nevojë për sqarim shtese
--	-------------------------------------	---

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

